

## **KERKESE PER PROPOZIM**

Tirane me 18.09.2020

**Subjekti: Marrje objekt me qera me funksion njesi biznesi per ProCredit Bank Albania sh.a.**

**I/E nderuar,**

Banka ProCredit njofton te interesuarit/ofertuesit se kerkon te marre me qera objekt per ushtrimin e veprimtarise se biznesit, ne Shkoder dhe Korce duke u bazuar ne kriteret e meposhtme:

- Objekti duhet te jete prane zonave te zhvilluara te banimit ne qytetet perkatese (e preferueshme ne qender te qytetit).
- Siperfaqia e shfrytezueshme e ambientit duhet te jete 100-130 m2.-
- Objekti duhet te jete ne katin e pare –dhe eshte e preferueshme qe kuota e godines te jete 2-3 kembeshkalle mbi kuoten e trotuarit.
- Lartesia e objektit duhet te jete minimumi 3 m.
- Prane objektit duhet te kete mundesi per minimumi 2 vende parkimi.
- Fasade te konsiderueshme (vizualitet nga rruga).
- Objekti te jete i hipotekuar (dokumentacioni vertetues te jete i tre muajve te fundit) dhe te kete nje plan rilevimi te hartuar nga nje inxhinier/subjekt i licensuar;
- Nisur nga rendesia e larte, objekti duhet te jete i pershtatshem per ruajtjen e sigurise se ambientit;
- Ne objekt te jete i siguruar furnizimi pa nderprerje me energji elektrike
- Objekti te kete ne dispozicion gjenerator per te perballuar furnizimin me energji ne rast nderprerje nga OSHEE dhe ne mungese te tij eshte e detyrueshme te kete hapësira per vendosjen e tij nga Banka
- Objekti duhet te kete akses tek hyrja kryesore per mjetet e transportit ne interes te Bankes si edhe mjetet e sherbimeve te emergjences
- Aktivitetet qe ushtrohen ngjitur me kete objekt duhet te jene te pranueshme nga niveli i rrezikut.

### **Oferta financiare:**

Kuotimi juaj duhet te paraqese vleren e detyrimit mujor te qerases per m2 .

- Oferta te jete e shprehur ne Leke perfshire te gjitha detyrimet tatimore
- Afati i bashkepunimit jo me pak se 5 vjet

Shenim:

Ne rast te aplikimit si subjekt me veprimtari real estate, lutemi te specifikoni komisionin qe ju aplikoni ne rast se opioni i paraqitur nga ju perzgjidhet nga Banka

Ne rast te se oferta juaj eshte e shprehur ne Euro, per reference do te aplikohet kursi kembimit publikuar nga Banka e Shqiperise ne daten e dorezimit te ofertave.

### **Kerkesa te tjera:**

Ne vijim te ofertes financiare eshte e nevojshme qe te plotesohet dhe te dergohet dokumentacioni ligjor si me poshte:

1. Dokumentat e pronesise se pasurise se paluajtshme, Certificate pronesie, kartele dhe harte treguese (kartela dhe harta treguese e pasurise duhet te jene leshuar jo me vone se 3 muaj nga data e dorezimit).
2. Vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike

Sebashku me dokumentacionin e kerkuar me siper ju lutemi te bashkangjisni edhe foto te objektit/ambientit te propozuar.

**Shenim i rendesishem:**

Banka ruan te drejten te vizitoje objektin/ambientin e propozuar dhe ne perfundim te kseaj procedure do te perzgjedhe objektin/ambientin me te pershtatshem per nevojat e saj.

Ju lutemi te dergoni kuotimin tuaj jo me vone se data **28 Shtator ora 16:00** ne adresen [info\\_procurement@procredit-group.com](mailto:info_procurement@procredit-group.com).

Per cdo paqartesi ju lutem kontaktoni ne numrin + 355 4 389389.

Per cdo ankese ne drejtim te procesit te prokurimeve jeni te lutur te kontaktoni ne adresen : [albankesaprokurime@procredit-group.com](mailto:albankesaprokurime@procredit-group.com)

ProCredit Bank Albania  
Head Office  
Addressa: "Dritan Hoxha" Street,  
Laprake, Tirane  
Tel: +355 42 389 389

**Ju faleminderit,**

**ProCredit Bank**